



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më _____ 2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: : “Blerje ushqime”, i ndarë në 5 lote

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Ushqim për fëmijë 15884000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 23,316,665.00 (njëzetë e tre milion e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH:

Loti 1: “Blerje bukë” me fond limit 2,066,640(dy milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzetë) lekë pa tvsh

Loti 2: “Blerje fruta, perime” me fond limit 5,779,980(pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh

Loti 3: “Blerje mish dhe nënprodukte të tij” me fond limit 3,924,000(tre milion e nëntëqind e njëzetë e katër mijë) lekë pa tvsh

Loti 4: “Blerje qumësht dhe nënprodukte të tij” me fond limit 7,543,513(shtatë milion e pesëqind e dyzetë e tre mijë e pesëqind e trembëdhjetë) lekë pa tvsh

Loti 5: “Blerje ushqime koloniale” me fond limit 4,002,532(katër milion e dy mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim Oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, neneve 26 dhe 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të leshuara nga administra tatimore për gjatë tre viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës të lotit/lotëve për të cilin/cilët konkuron.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, minimalisht xhiro vjetore e njërit prej viteve të periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e ulët se shumica e vlerave të kërkuara të xhiros minimale, të lotëve për të cilët OE/BOE rezulton fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Per tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nëni 29. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor. **Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt të kontratës.**

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 2 vitet e fundit financiare(2022 - 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nëni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me aktekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nëni 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Përauditimin ligjor, organizimin e profesionistëve audituesit ligjor dhe kontabilistët miratuar”, i ndryshuar “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të

pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese. **Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt të kontratës.**

2.2.3 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të lotit/loteve për të cilin/cilët konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit/lotëve për të cilin/cilët konkurron, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë që produktet e kërkuara plotësojnë standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt të kontratës.

2.3.4 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë një automjet për kryerjen e furnizimit të ushqimeve të lotëve 1, 2, 5. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor, si dhe lejen higjieno sanitare. *Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.*

2.3.5 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë një automjet frigoriferik për kryerjen e furnizimit të ushqimeve të lotëve 3, 4. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor, si dhe lejen higjieno sanitare. *Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.*

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur bazuar në **Rekomandim nr.10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe

dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Me urdhër nr.35 datë 03.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Vlorëeshtë ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit. Nga ky grup janë hartuar sipas shkresave bashkëlidhur dhe është mbajtur procesverbali përkatës.

*Shënim:Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT